



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/367

Datë: 20.06.2019

Mbështetur në nenin 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës me datë:31.10.2008 (nr.01/871, datë 12.11.2008) dhe Rregulloren nr.02/175 datë:30.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve, dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës me datë:20/06/2019 ;

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -VII- (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2019 të legjislaturës së -VI-, e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: 27.06.2019 duke filluar nga ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftohet z/zj. _____ që të marrë pjesë në këtë mbledhje.
Për këtë mbledhje propozoj këtë,

R E N D I D I T E S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/115 datë:17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2020-2022.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/203 datë:28.03.2019 të parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.03/281 datë:17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë për Administratë për miratimin e draft-Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Malishevës
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të komunës nr.01/526 datë:25.04.2019,për marrjen e vendimit për procedurë të mëtejme për caktimin e lokacionit për “ Ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpikë” në Komunën e Malishevës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597 datë: 06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore n fshatin Panorc, KK. Malishevë.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020.
7. Shqyrtimi i kërkesës nr. 05/225 datë:06.06.2019 për inicim të procedurave për hartimin e hartës zonale të Komunës.
8. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2019.
9. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/347,datë:11.06.2019 për miratimin e Raportit për performancë komunale për vitin 2018.

10. Shqyrtimi i Raportit për kompensimin e tri pagave përcjellëse, sipas kërkesës së KPF-së dhe marrja e vendimit për kompensimin e tyre.
11. Shqyrtimi i raportit për përgatitjen e korrje- shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi.
12. Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve të Komunës së Malishevës.
13. Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/303 datë:22.05.2019 e parashtruar nga Sindikata Komunale e Arsimit parauniversitar (SKAP) në Malishevë.
14. Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/305 datë:23.05.2019 e parashtruar nga përfaqësuesi i shoqatës “SHËN TEREZA” dega në Malishevë.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/53 datë:17.05.2019 e parashtruar nga z.Rexhep S. Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/58 datë:27.05.2019 e parashtruar nga z.Arsim S.Krasniqi nga fshati Terpezë e Poshtme, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/59,datë:28.05.2019 e parashtruar nga z. Fadil Thaçi fshati Mirushë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/60, datë:29.05.2019 e parashtruar nga z. Jetfir Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/61,datë: 29.05.2019 e parashtruar nga z. Fehmi Kryeziu nga fshati Bubavec, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/62.datë:05.06.2019 e parashtruar nga z.Halit Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/66, datë: 20.06.2019 e parashtruar nga z.Ali Feriz Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
22. Të ndryshme.

Ardhja e juaj është e domosdoshme.
Malishevë Qershor - 2019

